



**Bashkimi Evropian  
Instrumenti për ndihmën Para-Anëtarësimi  
Për Zhvillimin Rural – IPARD II**

**NJOFTIM PËR  
THIRRJEN E PARË PËR APLIKIME Nr. 01/2018  
Nga Programi IPARD II**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural e Shqipërisë shpall thirrjen e Parë për dorëzimin e Aplikimeve në kuadër të Programit IPARD II nga Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimi (IPA) për Zhvillimin Rural (IPARD) me qëllim të zhvillimit të Sektorit të Agro Ushqimor.

**Thirrja e parë do të qëndrojë e hapur nga data 30 Nëntor 2018 deri në datën 30 Janar 2019, ora 16:30, me orën lokale.**

Thirrja është e hapur për të gjithë personat (persona fizik dhe juridikë), puna dhe veprimtaria e të cilëve zhvillohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në fushat e prodhimit bujqësor/ose të agro-përpunimit dhe rural me fokus në masat e mëposhtëme:

**Masa 1:** "Investimet në asetet fizike të fermave bujqësore" me fokus të veçantë në sektorët e mëposhtëm:

- Qumësht
- Mish
- Fruta
- Perime
- Vresht

**Masa 3:** "Investimet në përpunim dhe tretimin e produkteve bujqësore" me fokus të veçantë në sektorët e mëposhtëm:

- Qumështidhe përpunimii qumështit
- Përpunimii mishit
- Përpunimii frutave dhe perimeve
- Vera

**Masa 7:** "Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit" me fokus të veçantë në sektorët e mëposhtëm;

- Sigurimi dhe prodhimi i bimëve medicinale dhe aromatike, kërpudhave, mjaltit, kërmijve dhe materialeve për prodhimin e vajrave esenciale;
- Përpunimi dhe tregëtimi në nivel ferme i produkteve bujqësore (qumështi, mishi, frutat perimet dhe verës);
- Përpunimi dhe tregëtimi i bimëve medicinale dhe aromatike të egra apo të kultivuara, kërpudhave, vaji i ullirit, mjalti, peshku dhe produktet e peshkut, prodhimi dhe marketingu i vajrave esenciale;
- Akuakultura;
- Turizmi i natyrës dhe ai rural;
- Shërbime për popullsinë dhe bizneset rurale;
- Industria e artizanatit dhe punishtet e prodhimit;
- Prodhimi dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme.

*Buxheti i përgjithshëm në dispozicion të kësaj thirrje është 50.33 milion EURO nga të cilat 75% ose 37.74 Milion EURO kontribut i BE dhe 25% ose 12.58 Milion EURO kontribut i buxhetit të shtetit.*

**Masa 1:** me buxhet total 21.65 milion EURO, me një minimum prej 10 000 EURO dhe maksimum 500 000 EURO. Përqindja e mbështetjes është 60% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit, 65% nëse investimi bëhet nga një fermer i ri (nën 40 vjeç), 70% për investimet në zonat malore.

**Masa 3:** me buxhet total 20.37 milion EURO, me një minimum 25 000 EURO dhe maksimum 2 000 000 EURO. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 50% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

**Masa 7:** me buxhet total 8.30 milion EURO, me një minimum 10 000 EURO, maksimumi 400 000 EURO. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 65% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të marrin informacionin e duhur në **Udhëzuesin për Aplikantët** lidhur me llojet e investimeve të pranueshme, aplikantët e pranueshëm, kriteret e përzgjedhjes dhe rregullat e dorëzimit të aplikimeve, i cili mund të kërkohej si një kopje e printuar (falas) në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) gjatë orëve të punës 08:00-16:30.

Gjithashtu, Udhëzuesi për Aplikantët dhe formatet zyrtare të dokumenteve që duhet të përdoren (formulari i aplikimit, plani biznesit) mund të **shkarkohen në versionin zyrtar nga data 30 Nëntor 2018** nga faqja e internetit: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al) dhe <http://www.bujqesia.gov.al>.

**Dorëzimi i aplikimeve fillon nga data 30 Nëntor 2018 deri në datën 30 Janar 2019 sipas orarit zyrtar 08:00 -16:30.**

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen **vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së** në zarfe të mbyllura me titullin *Thirrje për Dorëzimin e Aplikimeve*, së bashku me titullin e masës, emrin e plotë dhe adresën e aplikantit dhe me shënimin **“Të mos hapet përpara dorëzimit”**.

Aplikimet duhet të dorëzohen ose:

- Nëpërmjet dërgesës postare rekomande, ose
- Dorazi (duke përfshirë shërbimet koriere) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga:

<Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural  
Rruga “Muhamet Gjollësia”, Nr.56  
Tiranë, Shqipëri>

**Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo e-mail) apo të dërguara në adresa të tjera do të refuzohen.**

**Çdo aplikim i dorëzuar apo marrë pas përfundimit të afatit do të refuzohet automatikisht.**

Autoriteti Kontraktues do të ketë pronësinë e të gjitha aplikimeve që do të dorëzohen. Si pasojë, aplikantët nuk do të kenë të drejtë t'i marrin mbrapsht aplikimet e tyre.

**Shënim për aplikantët potencialë:**

Aplikimet e dërguara në mënyra ose në adresa të tjera nuk do të pranohen.

Aplikimet e dorëzuara apo të marra pas skadimit të afatit përfundimtar do të skualifikohen automatikisht.

Aplikimet e dorëzuara pa formatin e kërkuar të Formularit të Aplikimit do të skualifikohen automatikisht.

Aplikimet e dorëzuara pa formatin e kërkuar të Planit të Biznesit do të skualifikohen automatikisht.